



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



## YOUTH EXCHANGE AND STUDY

### Mësoni më shumë për këtë program të ri shkëmbimi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës

**YES – Youth Exchange and Study** është një program pa pagesë që siguron bursa studimi për nxënësit e shkollave të mesme nga vendet YES për të kaluar deri në një vit akademik (2020-2021) në Shtetet e Bashkuara, duke jetuar me familje amerikane dhe duke ndjekur një shkollë të mesme amerikane.

Fokusi i programit është zhvillimi i komunikimit ndërmjet qytetarëve nga Shtetet e Bashkuara dhe vendeve partnere, me qëllim ngritjen e mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellë. Nxënësit jetojnë në një familje pritëse, ndjekin një shkollë të mesme, angazhohen në aktivitete për të mësuar mbi shoqërinë dhe vlerat amerikane, sigurojnë aftësi drejtimi dhe ndihmojnë në edukimin e amerikanëve mbi vendin dhe kulturën e tyre.

**Ky program mbështetet financiarisht nga Departamenti Amerikan i Shtetit.**

#### Faza e parë e konkurimit:

| Qyteti | Data          | Adresa   |
|--------|---------------|--|
| Fier   | 1 nëntor 2019 | Shkolla e mesme “Flatrat e Dijes”<br>Lagja 1 Maj                                 |
| Tiranë | 2 nëntor 2019 | Universiteti “Marin Barleti”, Kampusi 2,<br>Rruga “Frang Bardhi”, Selitë, Tiranë |

Të gjithë nxënësit duhet të regjistrohen personalisht ditën e testimit. Testi i parë do të bëhet në të njëjtën ditë dhe orë që do të përcaktohet në momentin e regjistrimit. Për të gjithë ata që kualifikohen, testimi i dytë do të bëhet të nesërmen. Një listë me pjesëmarrësit e raundit të dytë do të bëhet publike në mbrëmjen e ditës së parë të testimit.

**NËSE DËSHIRONI TË REGJISTROHENI PARAPRAKISHT PËR TESTIMIN NË TIRANË NË ORARIN QË DËSHIRONI, NA DËRGONI NJË E-MAIL NË ADRESËN**

[tirana@americancouncilssee.org](mailto:tirana@americancouncilssee.org)

#### Aplikanti duhet të plotësojë këto dy kushte:

- Datëlindja nga **1 janar 2003 – 15 korrik 2005**
- Nxënës në shkollë të mesme, klasa 10 ose klasa 11
- Nxënës me rezultate të mira
- Të kenë nota të mira
- Njohuri të mira të gjuhës angleze
- Të jetë shtetas shqiptarë
- Nxënësit me aftësi të kufizuar duhet të jenë të lindur nga **15 shkurt 2002-15 korrik 2005** dhe të jenë në cilindo klasë.

#### Dokumentet që duhet të paraqiten:

##### Aplikanti duhet të paraqesë:

- Fotografi të kohëve të fundit 3 x 4 cm;
- Pasaportë, certifikatë lindjeje me fotografi; ose kartë identiteti
- një stilolaps të zi